



VENDIM

Nr. 72, Datë 18.07.2013

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A PËR DHËNIE
UDHËZIMI PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të Pikës 4.8 të Modelit të Tregut, miratuar me VKM nr. 338 date 19.03.2008, pikës 3.1 dhe 3.16.4 të Licensës së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të dates 18.07.2013, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje për dhënie udhëzimeve për importin e energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtorise Juridike dhe te Licensimit,

Pasi Konstatoi:

- OSSH është përgjegjëse për importin e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes;
- Se statusi i aministrimit të përcaktuar në nenin 18, pika 4, gërma c) të Ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, është i përkohshëm;
- Gjendjen financiare të shoqërisë, duke patur parasysh operimin në bazë të një skeduli të pagesave;
- Humbjet faktike në sistemin e shpërndarjes përlogariten rreth datës 14 të muajit pasardhës, që e bën prokurimin në bazë mujore të jetë më afër realitetit.

Vendosi:

1. CEZ Shpërndarje të kryejë procedurat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi baza mujore per periudhen gusht –dhjetor 2013.
2. CEZ Shpërndarje për prokurimin e energjisë elektrike mbi bazë mujore duhet të zbatojë procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Prokurimit të Energjisë Elektrike nga ana e OSSH miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr.42 date 25.05.2009.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 72, Datë 18.07.2013

MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A PËR DHËNIE
UDHËZIMI PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Sokol Ramadani	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____